



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA SHIJAK
NJESIA E PROKURIMIT**

Data 14.02.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“BLERJE USHQIME PËR KOPËSHTIN DHE CERDHEN, PËR NEVOJA TË BASHKISË
SHIJAK ”,**

TIPI I KONTRATËS- MALL

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Produkte
ushqimore te ndryshme **1580000-6**; Ushqim per femije **15884000-8**.

VLERA E FONDIT LIMIT:

3.200.000 (tre milion e dyqind mijë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, njësia e prokurimit në Bashkinë Shijak ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertes ekonomike.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të paktën 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-se, për të cilin duhet të paraqitet vërtetimi i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe nenin 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2021 – 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.3 Përvoja e ngjashme :

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontrata të mëparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet të jete të minimalisht deri në 20% e vlerës të kontrates që po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara . (Per kontratat në sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Aftësitë teknike dhe profesionale

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën përkatëse për prodhim dhe/ose tregtim të produkteve objekt prokurimi, Licence kategoria II.1.A.1: “ Prodhim , perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit .

Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kane detyrim ligjor të liçensohen nga QKB, duhet të deklarojne ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit , **ndër të tjera që është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv.**

2.3.3.Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera nje njesi tregtare ne te cilin magazinon mallrat e kerkuara objekt i ketij prokurimi, per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates apo marreveshjes kuader , per te cilin duhet te paraqese:

- **Aktin e pronesise ose Kontraten e marrjes me qira te objektit**, shoqeruar me dokumentacionin perkates te pronesise se objektit qe ka pronari, i cili e jep me qira.
- **Lejen higjeno-sanitare te objektit te vlefshme** te leshuar nga organet kompetente te Ministrise se Shendetesise ne rrethet perkatese (Inspektoriat qe mbulon fushen e shendetit) ose vertetim per plotesimin e kushteve higjeno-sanitare nga organet kompetente ne RSH.

Ambienti duhet te plotesoje te gjitha kushtet higjeno-sanitare dhe tekniko teknologjike. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vetedeklarim per respektimin dhe zbatimin e kushtet higjeno-sanitate dhe tekniko teknologjike.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t’i kërkoje ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi **1(nje) automjet i cili duhet të jetë frigoriferik**, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi dhe sigurimin e detyrueshëm të mjetit. Në rastin e marrjes me qira kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, date 19.05.2021, të ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

2.3.5. Në respektim dhe zbatim të Rekomandimit të APP dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku të deklarojë se mjeti frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve objekt i kësaj procedure, kanë rregjister perkates per monitorimin e temperatures sipas Udhezimit te Ministrise se Bujqesise nr.22, date 25.11.2010 ” Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”.

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë lejen higjieno-sanitare të mjetit të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet perkatese (Inspektoriati që mbulon fushën e shëndetësisë) ose vërtetim për plotësimin e kushteve për tregtimin e mallrave ushqimore nga Institucionet Kompetente në RSH.

Sqarim për ofertuesit : Në respektim dhe zbatim të **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, date 19.05.2021, të ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore

Shenim : Në respektim dhe zbatim të Rekomandimit të APP dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 , AK Bashkia Shijak ben me dije se Operatori Ekonomik i

shpalluar fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues , ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

2.3.8. Ne respektim dhe zbatim te Rekomandimit te APP dhe Autoriteti Kombetar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku te deklaroje se se zbaton dhe garanton kerkesat e ligjit nr.9863 date 28.01.2008 ” Per Ushqimin”, i ndryshuar per furnizimin /shperndarjen me produkte ushqimore ne ambientet e percaktuar nga AK , si edhe per ruajtjen e higjenes dhe mjedisit , kushteve teknike – teknologjike dhe personelit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ligjin nr.9863 date 28.01.2008 ” Per Ushqimin”, Rekomandimit te APP dhe Autoriteti Kombetar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 , Udhezimit te Ministrise se Bujqesise nr.22, date 25.11.2010 ” Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor”, etj. .

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për tregtimin , prodhimin / furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

3. Operatori ekonomik duhet te paraqese :

3.1 Nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, sipas standardit nderkombetar ISO 9001 ose ekuivalent ose te perdituesar.

Çertifikata e vlefshme duhet te jete e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne zbatim te nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 36, 37 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ ekuivalent ”.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t’i kërkoje ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.****

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe hartimit te specifikimeve teknike.

Shenim : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “ Cilesia e pare”, ky përcaktim eshte i barasvlefshem me termin “ ekuivalente”.

Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike

Albiona Mehmeti

ElonaTikvina

Rexhina Keçi